



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN

Numri i lëndës: 2020:027569
Datë: 02.07.2024
Numri i dokumentit: 05885254

C.nr. 113/2022

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, gjyqtarja Mevlide Shabani, me praktikanten e gjykatës Djellza Kurti, në çështjen kontestimore të paditësit A. H., nga fsh. Zh., të cilin sipas autorizimit e përfaqëson av. Erëmira Halimi, nga Gjilani, ndaj të paditurve S. H. dhe J. H., që të dy nga fsh. Zhegër, me objekt kontesti vërtetimi i të drejtës së pronësisë, pas mbajtjes së seancës gjyqësore më datë 01.07.2024, mori dhe shpalli këtë:

A K T G J Y K I M
Në bazë të pohimit

I. APROVOHET e bazuar kërkesëpadia e paditësit A.(A.) H., nga fshati Zh. K. Gjilaan, e paraqitur ndaj të paditurave: S. H. dhe J. H., që të dy nga fsh. Zh. dhe **VËRTETOHET** se paditësi në bazë të blerjes dhe mbajtjes, është pronar i ngastrës kadastrale P-.....-.....-**0 në sipërfaqe prej 1755 m²**, parcelë, pronë private, në vendin e quajtur “TRSKA XHERAMIDNICA” Zona kadastrale Zhegër Zyra kadastrale Komuna Gjilani, dhe ngastrës kad.nr. -70403026-**03120-0 në sipërfaqe prej 2668 m²**, parcelë, pronë private, në vendin e quajtur “SHEVARINA” Zona kadastrale Zhegër Zyra kadastrale Komuna Gjilani, pjesa e pronës 1/1, sipas certifikatës pronësore me numër të lëndës-20, të datës 16.01.2020, të cilat evidentohen në emër të I. H., ish babai i të paditurve, ashtu që **DETYROHEN** të paditurit që t’ia njohin këtë të drejtë paditësit, në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij Aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm.

II. Secila palë i bartë shpenzimet e veta të procedurës kontestimore.

A r s y e t i m

Paditësi A.H., nga fsh.Zhegër, përmes të autorizuarës së tije av. Erëmira Halimi, në këtë gjykatë më datë 24.02.2020, ka ushtruar padi kundër të paditurve S. H. dhe J. H., që të dy nga fsh, me objekt kontesti për vërtetimin e të drejtës së pronësisë, duke theksuar se nga i padituri i parë S. H.i, i ka blerë parcelat P-.....-.....-**0 në sipërfaqe prej 1755 m²**, parcelë, pronë private, në vendin e quajtur “TRSKA XHERAMIDNICA” Zona kadastrale Zhegër Zyra kadastrale Komuna Gjilani, dhe ngastrës kad.nr. -.....-.....-**0 në sipërfaqe prej 2668 m²**, parcelë, pronë private, në vendin e quajtur “SHEVARINA” Zona kadastrale Zhegër Zyra kadastrale

Komuna Gjilan, pjesa e pronës 1/1, në shumë prej 50,000.00CHF (pesëdhjetëmijë franga Zvicrane) që nga viti 1993, në të cilat ka ndërtuar shtëpin e banimit e më pas atë shtëpi e ka rrënuar dhe ka ndërtuar dy shtëpi për djemt e tije e në të cilat edhe tani jetojnë, në mënyrë të qetë dhe të papenguar nga askush e edhe as nga të paditurit e lartcekur.

Gjykata duke marrë parasysh se të paditurit me autorizimin e dhënë përfaqësuesit të tyre F. H., me datë 09.03.2022, e kanë pohuar edhe kërkesëpadinë e paditësit, e me qëllim të ekonomizimit të procedurës, ka caktuar seancë për datën 01.07.2024, në të cilën kanë qenë prezent, paditësi me përfaqësuesen e tije si dhe i autorizuari i të paditurve .

E autorizuar e paditësit Ermira Halimi, si në shqyrtimin përgatitor, kryesor ashtu edhe në fjalën përfundimtare ka deklaruar se mbetet në tersi pranë padisë dhe kërkesë padisë duke theksuar se paditësi i ka blerë ngastrat tani kontestuese në vitin 1989, në shumën prej 50.000.00 franga Zvicrane, sipas kontratës gojore (djemve të agjës së tije), tani të paditur, ka paguar çmimin kontraktues dhe menjëherë ka hyrë në posedim dhe shfrytëzim të së njëjtave e të cilat edhe sod i shfrytëzon në mënyr të qetë e të pa penguar nga askush e as nga ana e tani të paditurve. Në fund gjykatës i ka propozuar të njëjtën ta aprovoj si të bazuar pasi që nuk ka asgjë kontestuese, dhe këtë të drejtë paditësi e ka fituar edhe në bazë të parashkrimit fitues - me mbajtje.

Përfaqësuesi i të paditurve F. H., ka deklaruar se nuk e konteston kërkesëpadinë e paditësve duke theksuar se babai i tije dhe agja i tije të cilët tani janë në moshë të shtyre, ia kanë shitur ngastrat e cekura në padi paditësit të cilin e kanë edhe familjarë dhe nuk ka asgjë kontestuese lidhur me këtë çështje civilo juridike. Gjykatës i ka propozuar që të bie aktgjykim në bazë të pohimit pasi që për këto parcela nuk është rregulluar trashëgimi pasi që e kanë të njohur faktin se i janë shitur tani paditësit.

Me këtë gjykata ka konstatuar edhe legjitimitetin real të palëve në kontest, posaçërisht nga certifikata e vdekjes në emerë të I. H., me nr. rendor11, të lëshuar nga Zyra e gjendjes civile në Zhegër, me datë 28 janar 2020, certifikata e lindjes në emër të S. H.t me nr. serik E, e lëshuar nga zyra e Gjendjes Civile në Gjilan, me datë 10 shkurt 2022, certifikata e lindjes në emër të J. H., me nr. serik E, e lëshuar nga zyra e Gjendjes Civile në Gjilan, me datë 10 shkurt 2022, me të cilat vërtetohet se të paditurit janë trashëgimtarë ligjore të ndjerit I. H., ashtu që ka konstatuar se të drejtat që janë objekt i këtij raporti civilo-juridik janë në disponimin e të drejtave të palëve, prandaj në kuptim të nenit 148 paragrafi 1 të Ligjit për Procedurën Kontestimoroe (LPK-ës), me të cilin përcaktohet se *“në qoftëse i padituri deri në përfundimin e shqyrtimit kryesor të çështjes e pohon kërkesëpadinë pjesërisht apo tërësisht, gjykata e jep, pa shqyrtim të mëtejshëm, aktgjykimin me të cilin e aprovon pjesën apo gjithë kërkesëpadinë (aktgjykimi në bazë të pohimit), andaj vendosi që pa shqyrtim të mëtejshëm t’a aprovojë kërkesëpadinë e paditësit si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.*

Vendimi mbi shpenzimet procedurale është marrë në bazë të nenit 452 par. 4 të LPK-ës.

Nga arsyet e theksuara më lartë, e bazuar në nenin 394, 395, 143 dhe 148 të LPK-ës, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN
Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil
C.nr. 113/2022, më datë 02.07.2024

Gj y q t a r j a,
Mevlide Shabani

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa Gjykatës së Apelit në Prishtinë, në afat prej 15 ditësh pas ditës së pranimi të njëjtit, vetëm për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore. Ankesa dorëzohet në dy ekzemplarë përmes kësaj gjykate.

Në kuptim të nenit 181 par.2 të LPK-ës ankesa mund të paraqitet vetëm për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës kontestimore apo nga shkakut se deklarata e pohimit është dhënë në lajthitje apo nën ndikimin e dhunës apo mashtrimit.